



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 16 dhjetor 2024  
Nr. ref.: RK 2586/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI294/23**

Parashtrues

**Sadri Mazreku**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së**  
**Aktgjykimit PML. nr. 336/2023, i 25 shtatorit 2023, të Gjykatës Supreme të**  
**Kosovës**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Bajram Ljatifi, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Sadri Mazreku, me vendbanim në Komunën e Malishevës, (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Artan Qerkini, avokat nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [PML. nr. 336/2023] të 25 shtatorit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [PA1. nr. 1805/22] e 12 prillit 2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [P. nr. 274/2015] e 21 shtatorit 2022 të Gjykatës Themelore në Gjakovë – dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij, të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 29 dhjetor 2023, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij dorëzoi kërkesën e parë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 9 janar 2023, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën e dytë në Gjykatë, të cilën Gjykata e regjistroi si plotësim të kërkesës së parë.
7. Më 16 janar 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI294/23] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Vendimit [Nr. KSH. KI294/23] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).
8. Më 24 janar 2024, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës kësaj të fundit.
9. Më 31 janar 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë shkresë për plotësimin e provave të dorëzuara.
10. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
11. Më 13 maj 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë shkresë shtesë për plotësimin e provave të dorëzuara.

12. Më 2 shtator 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë shkresë shtesë për plotësim të provave.
13. Më 24 shtator 2024, Gjykata i kërkoi përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës që të dorëzojë kopjet e ankesës dhe të kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë, të dorëzuara në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme.
14. Me 29 tetor 2024, gjyqtari Safet Hoxha, në bazë të nenit 18 (Përjashtimi i gjyqtarit) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, kërkoi përjashtimin e tij në cilësinë e gjyqtarit raportues dhe nga vendimmarrja në rastin KI294/23.
15. Më 30 tetor 2024, Kryetarja përmes Vendimit [Nr. Ref. KK741/24] aprovoi kërkesën e gjyqtarit Safet Hoxha për përjashtim.
16. Më 1 nëntor 2024, Kryetarja përmes Vendimit [Nr. GJR.KI294/23], në vend të gjyqtarit Safet Hoxha, e caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi gjyqtar raportues.
17. Më 26 nëntor 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

18. Nga dosja e lëndës rezultoi se parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë, lidhur me një kontest për vërtetimin e pronësisë, sipas trashëgimisë që ishte duke u zhvilluar në këtë Gjykatë, e që kishte rezultuar në nxjerrjen e Aktgjykimit [C. nr. 87/2009] të 3 qershorit 2014, kishte paraqitur Aktgjykimin [C. nr. 85/2001] të 19 prillit 2002 të Gjykatës Komunale në Malishevë (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi [C. nr. 85/2001]), duke pretenduar se kishte ekzistuar një person [Rr. M.], që kinse ishte vëllai i parashtruesit të kërkesës, i cili kishte trashëguar një pronë, dhe të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte mbajtur emrin e [Rr. M.] dhe pastaj kishte trashëguar atë pronë së bashku me disa persona të tjerë.
19. Më 18 shkurt 2015, Prokuroria Themelore në Gjakovë kishte ngritur aktakuzë ndaj parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale "*Legalizimi i përmbajtjes së rreme*" nga paragrafi 1 i nenit 403 (Legalizimi i përmbajtjes së rreme) i Kodit Nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK), sepse u dyshua që parashtruesi i kërkesës kishte vënë në lajthitje Gjykatën Themelore në Gjakovë – dega në Malishevë, dhe gjyqtarin [H. K.], duke prezantuar një dokument të rrejshëm se ka ekzistuar një person me emrin [Rr. M.], për të cilin ka pretenduar se e ka vëlla.
20. Më 21 shtator 2022, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P. nr. 274/2015] shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale "*Legalizim i përmbajtjes së rreme*" nga paragrafi 1 i nenit 403 të KPRK-së, dhe e dënoi të njëjtin me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muajve, për shkak se i njëjti duke paraqitur Aktgjykimin [C. nr. 85/2001] që ndërlidhej me vërtetimin e pronësisë sipas trashëgimisë të ngastrës kadastrale me numër 893/1 me kulturë arë, në sipërfaqe prej 0.47,00/ha e ka vënë në lajthim Gjykatën Themelore në Gjakovë/dega në Malishevë. Gjykata Themelore arsyetoi se "*ka ekzistuar vetëm një [Rr. H. M.], nga babai [H.], nëna [R.], me numër të protokollit 203-15/7 Malishevë datë 13.10.1995, i lindur me 1893, ndërsa i vdekur më 25.04.1959, lëshuar nga Komuna e Rahovecit [...] ndërsa "I pandehuri e ka vënë në lajthim këtë Gjykatën duke e*

*prezantuar dokumentin e rrejshëm se ka ekzistuar një person me emrin [Rr. M.] (vëlla i të pandehurit), për arsye për me marrë pronën ngastrën kadastrale nr. 893/1, në sipërfaqe prej 0.47,00ha, edhe pse kjo pronë ka qenë e familjes rome [S. M.], e kur dihet se i pandehuri ka bërë propozim për vërtetimin e vdekshmërisë së [Rr. M.] (vëllait të tij), të cilin Gjykata e ka vërtetuar me aktvendimin Nd. Nr. 29/2001, dt. 09.04.2001, e Gjykatës nuk i ka prezantuar ndonjë dëshmi para vitit 1999”.*

21. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [P. nr. 274/2015] të 21 shtatorit 2022, të Gjykatës Themelore, duke pretenduar se kjo e fundit (i) gabimisht e kishte shpallur fajtor për veprën penale “Legalizimi i përmbajtjes së rreme”, për faktin se e ka paraqitur si provë në një procedurë gjyqësore, një Aktgjykim të Gjykatës Themelore i lëshuar nga gjykata si organ kompetent dhe në këtë rast, nuk ekziston dokumenti i rremë, siç parashihet në figurën e veprës penale konkrete; (ii) nuk kishte dhënë arsye të qarta lidhur me provat e administruara por vetëm kishte bërë përshkrim të provave; (iii) nuk kishte sqaruar provat të cilat ishin kontradiktore mes tyre; dhe (iv) lloji dhe lartësia e dënimit nuk përputhej me rrethanat e rastit.
22. Më 12 prill 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAI. nr. 1805/22] aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe ndryshoi Aktgjykimin [P. nr. 274/2015] e 21 shtatorit 2022 të Gjykatës Themelore, ashtu që (i) veprën penale e ricilësoi si “Legalizim i përmbajtjes së rreme” nga paragrafi 2 i nenit 403 (Legalizim i përmbajtjes së rreme) të KPRK-së; dhe (ii) në lidhje me sanksionin penal, dënimi i shqiptuar me burgim prej 9 (nëntë) muajsh u vërtetua dhe u vendos që të mos ekzekutohet nëse në periudhën prej 2 (dy) viteve, parashtruesi nuk kryen vepër tjetër penale. Gjykata e Apelit arsyetoi, ndër të tjera, se (i) “përdorimi i këtij vendimi gjyqësor [Aktgjykimin [C.nr.85/2001]] duke e ditur se është i mbështetur në fakte të rreme, nënkupton se i akuzuari ka qenë i njohur me këtë rrethanë [...]”; dhe (ii) “gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur, kur kohë të kryerjes e ka konstatuar datën 03.06.2014, duke llogaritur kohë të kryerjes, momentin e vendosjes në çështjen civile ku gjykata përkatëse është vënë në lajthim nga tani i akuzuari me rastin e vlerësimit të aktgjykimit të vitit 2002, pra duke e aprovuar përmbajtjen e këtij vendimi gjyqësor si të vërtetë, dhe duke e bazuar vendimin në këtë provë, përderisa i akuzuari duke qenë në cilësinë e palës së paditur, ka qenë në dijeni për përmbajtjen e rreme të kësaj prove”.
23. Në një datë të specifikuar, parashtruesi i kërkesës personalisht parashtrroi kërkesën e parë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [P. nr. 274/2015] të 21 shtatorit 2022 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit [PAI. nr. 1805/22] të 12 prillit 2023 të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje të paragrafit 3 të nenit 311 (Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues gjatë shtyrjes), të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejshëm: KPP), ndër të tjera, për faktin se në rastin e tij “shtyrja ka zgjatur më shumë se tre muaj dhe shqyrtimi është dashur të filloj rishitas, të mbahet para një trupi tjetër gjykues”.
24. Më 21 qershor 2023, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij parashtrroi kërkesën e dytë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [P. nr. 274/2015] të 21 shtatorit 2022 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit [PAI. nr. 1805/22] të 12 prillit 2023 të Gjykatës së Apelit, me ç’ rast në thelb: (i) përsëriti pretendimet ankimore të ankesës së tij në lidhje me vlerësimin e provave; (ii) theksoi se nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim sa i përket kryerjes së veprës penale siç pretendon se ishte theksuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore; si dhe (iii) konsideroi se vendimi gjyqësor nuk ishte arsyetuar.

25. Më 3 korrik 2023, parashtruesi i kërkesës, përmes një përfaqësuesi tjetër të tij, parashtroi kërkesën e tretë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [P. nr. 274/2015] të 21 shtatorit 2022 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit [PAL. nr. 1805/2022] të 12 prillit 2023 të Gjykatës së Apelit, për shkak të: (i) shkeljes esenciale të procedurës penale nga nënparagrafi 1.12 i paragrafit 1 të nenit 384 i KPP-së; (ii) shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale nga nënparagrafi 1.3 i paragrafit 1 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) i KPP-së.
26. Më 25 shtator 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 336/2023] refuzoi si të pabazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë parashtruesit të kërkesës, të paraqitura kundër Aktgjykimit [P. nr. 274/2015] të 21 shtatorit 2022 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit [PAL. nr. 1805/22] të 12 prillit 2023 të Gjykatës së Apelit, me arsyetimin se, ndër të tjera, *“Është e evidente që sipas dispozitës së nenit 311, par. 3 të KPP-së, kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor fillon rishtas. Por në rastin konkret në këtë çështje penale nuk është ndryshuar trupi gjykues sepse çështja është shqyrtuar nga gjyqtari i vetëm dhe atë brenda afatit të paraparë ligjor dhe nuk ka pas shtyrje të shqyrtimit ashtu siç pa të drejtë pretendohet në kërkesën e të dënuarit”*. Ndërsa lidhur me pretendimet tjera konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.

## **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

### *Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në kërkesën e dorëzuar më 29 dhjetor 2023*

27. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar i është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës, në plotësimin e kërkesës së tij më 9 janar 2024, gjithashtu pretendon se i është shkelur edhe e drejta e garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.
28. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendon se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak: (i) të interpretimit qartazi arbitrar të ligjit përkitazi me përmbushjen e elementeve të figurës së veprës penale; dhe (ii) mosarsyetim të vendimit gjyqësor.
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta në çështjen e tij kanë bërë interpretime ligjore dukshëm arbitrare që shpiten në konkluzione qartazi të gabuara në lidhje me përmbushjen e elementeve të figurës së veprës penale *“Legalizimi i përmbajtjes së rreme”*, për shkak se gjykatat e rregullta kanë konsideruar se aktgjykimet gjyqësore *“mund”* të konsiderohen si dokumente të rreme, respektivisht, që janë marrë në lajthitje. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës thekson se: *“[...] është shpallur fajtor me arsyetimin se e ka përdorur si provë në procedurë kontestimore, një aktvendim gjyqësor të nxjerrë në një procedurë tjetër gjyqësore kontestimore. Konkretisht, ai është akuzuar se ka fituar një kontest gjyqësor sipas një padie për vërtetim të pronësisë sipas trashëgimisë, që disa qytetar të Malishevës, me mbiemër të njëjtë [M], kanë bërë kundër parashtruesit dhe disa familjarëve të tij, lidhur me një parcelë tokësore. Si provë kryesore në këtë procedurë gjyqësore ai ka paraqitur një aktvendim të Gjykatës Themelore, të nxjerrë në procedurë jokontestimore, me të cilën vërtetohet se ka ekzistuar një person me emërin [Rr. M.] (vëlla i parashtruesit), i cili ka qenë me aftësi të kufizuara dhe se i njëjti ka vdekur pa lënë trashëgimtar në vitin 1971 dhe se parashtruesi e ka trashëguar parcelën në fjalë prej tij”*. Në këtë drejtim, ai citon Komentarin e Kodit Penal, të vitit 2014, ku ndër

të tjera, sipas tij, sqarohet se “[...] objekt i kësaj veprë penale nuk janë dokumente publike, që kanë karakter aktvendimi dhe vendimi, të cilat organi kompetent i nxjerr në bazë të procedurës së zbatuar dhe në bazë të vlerësimit të provave”. Për pasojë, parashtruesi i kërkesës konsideron se do të ishte jologjike që për përmbajtjen e aktgjykimeve që nxjerrin gjykatat, të akuzoheshin palët në procedurë, siç sipas tij, ka ndodhur në rastin konkret.

30. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se disa nga pretendimet kryesore kanë mbetur të paadresuara nga të gjitha shkallët gjyqësore, siç janë: (i) mosparaqitja nga gjykatat e fakteve dhe rrethanave që e përbëjnë figurën e veprës penale “*Legalizim i përmbajtjes së rreme*”; (ii) mosargumentimi si mund të legalizojë përmbajtjen e rreme të një aktgjykimi gjyqësor një person i cili është palë në procedurë; (iii) pretendimin të cilin e kishte ngritur në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, në lidhje me shkeljen e paragrafit 3 të nenit 311 (Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues gjatë shtyrjes) të Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejme: ish-KPP), respektivisht, që shtyrja e shqyrtimit ka zgjatur më shumë se 3 (tre) muaj dhe se është dashur që shqyrtimi të mbahet para një trupi tjetër gjykues dhe të shqyrtohen të gjitha provat; (iv) në lidhje me shqiptimin e dënimit; si dhe që (v) disa pretendime dhe argumente të tjera janë trajtuar në mënyrë sipërfaqësore, me argumente të përgjithshme, sipërfaqësore dhe gjuhë “*shabllonike*”.
31. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk janë trajtuar fare pretendimet e mbrojtjes se cilat kanë qenë veprimet e parashtruesit të kërkesës përmes të cilave ka kryer veprën penale, për të cilën është gjykuar dhe më saktësisht shprehet se:

*“Në mënyrë të veçantë, Gjykata Supreme nuk ka adresuar pretendimin kryesor të ngritur përgjatë tërë procedurës se as gjykata e shkallës së parë dhe as gjykata e shkallës së dytë nuk kishin paraqitur faktet dhe rrethanat të cilat do të tregonin figurën e veprës penale për të cilën është dënuar parashtruesi, pra në procedurën e zhvilluara në gjykatat e rregullta nuk është dhënë përgjigje e qartë se a mund të kryej veprën penale të “legalizimit të përmbajtjes së rreme” të një aktgjykimi gjyqësor, pala e cila si provë në procedurë paraqet një aktvendim tjetër gjyqësor? Si mund të shpallet fajtor një palë në procedurë, për përmbajtjen e një aktgjykimi që e nxjerr gjykata pas zhvillimit të procedurës kontestimore që nënkupron administrim të provave dhe konstatim të fakteve, që bëhet në mënyrë të pavarur nga gjykata?”*

*Në këtë sfond duhet vënë në dukje se, sidomos në procedurë penale kur individët shpallën fajtor dhe dënohen – që do të thotë me automatizëm iu kufizohen disa të drejta kushtetuese – standardi i arsyetimit të vendimeve duhet të jetë më i mprehtë. Kështu edhe GJEDNJ në mënyrë konstatante ka theksuar se në procedurë penale, në rastet e ndërhyrjeve/kufizimeve të të drejtave të garantuara me KEDNJ, duhet të shikohet në mënyrë të veçantë se a janë arsyetimet e dhëna nga gjykatat me formulime “automatike ose me stereotipe” si dhe a kanë shpërfillur gjykatat ndonjë pretendim të rëndësishëm të palës”.*

32. Në këtë drejtim, parashtruesi konsideron se aktgjykimi i kontestuar nuk ka përmbushur standardin e vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe për këtë mbështetet në praktikën gjyqësore të Gjykatës, respektivisht, në rastet [KI22/16](#) parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 2 majit 2017 [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017 dhe po ashtu në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, gjegjësisht në rastet [Hirvisaari kundër Finlandës](#) nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001 dhe [Tatishvili kundër Ruisë](#) nr. 1509/02, Aktgjykim i 22 shkurtit 2007.

33. Në fund të kësaj kërkesë, parashtruesi i kërkon Gjykatës që (i) të shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se aktgjykimet e kontestuara kanë shkelur nenin 31 të Kushtetutës; dhe (iii) të shpallë të njëjtat të pavlefshme duke rikthyer rastin në rigjykim.

*Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në kërkesën e dorëzuar më 9 janar 2024*

34. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu në plotësimin e kërkesës së tij më 9 janar 2024, shton se i është shkelur e drejta në mbrojtje të barabartë dhe gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak se: (i) i janë hequr dokumente nga dosja penale, respektivisht dokumenti me emërtimin “Abucni registar” apo ekstrakt nga regjistri i të drejtave pronësore në patundshmëri dhe se kur parashtruesi në procedurë penale kishte kërkuar që ky dokument të administrohej si provë, Gjykata Themelore e kishte refuzuar administrimin e saj me arsyetimin se është provë e natyrës civile dhe jo penale; (ii) sipas tij, aktgjykimi fajësues i tij mbështetej në prezumimin se ngastra lëndore ishte në pronësi të një familjeje rome pa u bazuar në prova, por vetëm në deklarinimin e palës së dëmtuar; si dhe (iii) ishte targetuar si fajtor i vetëm, edhe pse në këtë çështje mund të ishin akuzuar edhe familjarët e tij.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

*“1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

*2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

*[...]*”

### **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

#### **Neni 6**

#### **(E drejta për gjykim të drejtë)**

*“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

*[...]*

**Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës**

**Kapitulli XXXI**

**Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike**

**Neni 403**

**(Legalizimi i përmbajtjes së rreme)**

*“1. Kushdo që vë në lajthim organin kompetent që në një dokument publik, regjistër apo libër të vërtetojë një çështje të pavërtetë, të paraparë për të shërbyer si provë në një çështje ligjore, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.*

*2. Kushdo që përdorë dokumentin, regjistrin apo librin e tillë edhe pse e di së është i rremë, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni”.*

**Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës**

**Kapitulli XIX**

**Shqyrtimi Gjyqësor**

**Neni 311**

**(Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues gjatë shtyrjes)**

*[...]*

*3. Kur shtyrja ka zgjatur më shumë se tre (3) muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishtas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat.*

*[...]*”

**Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me plotësimin e kërkesës së parashtruesit**

35. Gjykata së pari vëren se parashtruesi i kërkesës e kishte paraqitur kërkesën e tij të parë përmes përfaqësuesit të tij ligjor më 29 dhjetor 2023, si dhe kërkesën e dytë më 9 janar 2024 në emrin e tij. Ai po ashtu kishte dorëzuar edhe 3 (tri) shkresa, në emrin e tij me qëllim të plotësimit të lëndës së tij me prova në datat: 31 janar 2024; 13 maj 2024; si dhe 2 shtator 2024.
36. Në vijim, në kuadër të shqyrtimit të plotësimeve të njëpasnjëshme të kërkesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht i referohet dispozitave përkatëse të Ligjit për Gjykatën dhe Rregulloren e saj të punës.
37. Gjykata i referohet paragrafit 4 të rregullit 26 (Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit të përgjigjeve) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

*“(4) Përveç nëse kërkohet nga Gjykata ose nëse merret leje me shkrim nga Gjykata, pala parashtruese nuk mund të dorëzojë asnjë dokument pas afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimin të kërkesës. Gjykata mund të urdhërojë një afat më të shkurtër kur një kërkesë i nevojitet trajtim i përshpejtuar”.*



38. Bazuar në dispozitat e lartcekura të Rregullores të punës së Gjykatës, rregullat e Rregullores së punës përcaktojnë që parashtruesit e kërkesës nuk mund të dorëzojnë asnjë dokument pas afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës, përveç nëse Gjykata kërkon plotësimin e kërkesës.
39. Prandaj, Gjykata marrë për bazë faktin, që kërkesa e parë e parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese është dorëzuar më 29 dhjetor 2023, ndërsa kërkesa e dytë është dorëzuar më 9 janar 2024, Gjykata konstaton se kjo e fundit dorëzuar brenda afateve procedurale të përcaktuara me Ligj dhe rregullin 26 të Rregullores së punës. Megjithatë, në lidhje me plotësimin e kërkesave të dorëzuara më 31 janar 2024, 13 maj 2024, si dhe 2 shtator 2024, Gjykata konstaton se të njëjtat janë dorëzuar jashtë afateve procedurale të përcaktuar me Ligj dhe rregullin 26 të Rregullores së punës (shih në mënyrë të ngjashme rastet e Gjykatës [KI133/20](#), me parashtrues *Raiffeisen Bank*, Aktgjykim i 30 marsit 2022, paragrafët 103-105; dhe [KI100/23](#), me parashtrues *Miradije Tusha, Naser Tusha, Artan Tusha, Ajshe Tusha, Hatixhe Tusha, Nadire Tusha dhe Nurhane Vladi-Tusha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 shkurtit 2024, paragrafët 56-57, si dhe [KI171/23](#), parashtrues *Latif Zariqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 prillit 2024, paragrafët 35-43)
40. Në këtë kuptim, Gjykata rithekson se afatet e përcaktuara me Rregulloren e punës, në kuptim të procedurës së shqyrtimit të kërkesës para Gjykatës, i shërbejnë sigurisë juridike, që nënkupton që palët në procedurë para Gjykatës janë paraprakisht të njoftuara në lidhje me (i) kushtet e dorëzimit të një kërkesë në Gjykatë, (ii) të drejtës së palës kundërshtare për të paraqitur përgjigje dhe (iii) afatit të dorëzimit të informatave dhe parashtrësve tjera brenda afateve të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës (shih rastin [KI100/23](#), me parashtrues *Miradije Tusha, Naser Tusha, Artan Tusha, Ajshe Tusha, Hatixhe Tusha, Nadire Tusha dhe Nurhane Vladi-Tusha*, të cituar më lart, paragrafi 58 dhe [KI171/23](#), parashtrues *Latif Zariqi*, cituar më lart, paragrafi 42).
41. Rrjedhimisht, Gjykata do të vazhdojë me shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, të ngritura përmes kërkesave të tij, të dorëzuara më 29 dhjetor 2023 dhe 9 janar 2024 në Gjykatë.

**Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës së parë të paraqitur përmes përfaqësuesit të tij ligjor më 29 dhjetor 2023, si dhe plotësimin e saj përmes kërkesës së tij të 9 janarit 2024**

42. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
43. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

44. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 (Kërkesa individuale), nenit 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe nenit 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

45. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është: (i) palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik përkatësisht Aktgjykimin [PML nr. 336/2023], i 25 shtatorit 2023, të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [PA1 nr. 1805/22] e 12 prillit 2023 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [P nr. 274/2015] e 21 shtatorit 2022 të Gjykatës Themelore; (ii) ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; dhe (iii) ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj; si dhe (v) e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
46. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, pika (d) e paragrafit 1 dhe paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës, përcaktojnë që:

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

*[...]*

*(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.*

*[...]*

*(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.*

47. Gjykata fillimisht thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së

punës. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GJEDNJ-së [Kemmachev kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykim i 24 nëntorit 1994, paragrafi 44 [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005, paragrafi 55; [Mentzen kundër Letonia](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008, dhe rastet e Gjykatës [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 prillit 2021, paragrafi 26; [KI107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021, paragrafi 53; dhe [KI05/23](#) parashtrues *Branislav Gajin*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2024, paragrafi 51).

48. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë si dhe pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të saj dhe ato të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
49. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me Aktgjykimin [P. nr. 274/2015] e 21 shtatorit 2022 të Gjykatës Themelore përmes të cilit e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale “*Legalizim i përmbajtjes së rreme*” nga paragrafi 1 i nenit 403 të KPRK-së, dhe e dënoi të njëjtin me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muajve. Më 12 prill 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1. nr. 1805/22] e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore me ç’ rast e ricilësoi veprën penale të “*Legalizimit të përmbajtjes së rreme*”, nga paragrafi 2 i nenit 403 të KPRK-së, si dhe vërtetoi dënimin me burgim, por shndërroi të njëjtin në dënim me kusht. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu parashtrroi 3 (tri) kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të cilat Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 336/2023] të 25 shtatorit 2023, i refuzoi.
50. Gjykata rithekson se parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë në shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak të: (i) interpretimit qartazi arbitrar të ligjit përkritazi me përmbushjen e elementeve të figurës së veprës penale; (ii) mosarsyetimit të vendimit gjyqësor; si dhe (iii) mospranimit të provave. I njëjti në plotësimin e kërkesës së tij, po ashtu përmend edhe (iv) shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës. Rrjedhimisht, në vijim, Gjykata do t’i shqyrtojë pretendimet e lartpërmendura të parashtruesit të kërkesës sipas ndarjeve të cekura më poshtë.

## **I. Përkritazi me pretendimet për interpretimin qartazi arbitrar të ligjit dhe të drejtën për vendim të arsytuar**

51. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta në çështjen e tij kanë bërë interpretime ligjore dukshëm arbitrare që shpjen në konkluzione qartazi të gabuara në lidhje me përmbushjen e elementeve të figurës së veprës penale “*Legalizimi i*

*përmbajtjes së rreme”, për shkak se ato kanë konsideruar se aktgjykimet gjyqësore mund të konsiderohen si dokumente të rreme, respektivisht, ai shprehet se: “[...] ai është akuzuar se ka fituar një kontest gjyqësor sipas një padie për vërtetim të pronësisë sipas trashëgimisë, që disa qytetar të Malishevës, me mbiemër të njëjtë [M], kanë bërë kundër parashtruesit dhe disa familjarëve të tij, lidhur me një parcelë tokësore. Si provë kryesore në këtë procedurë gjyqësore ai ka paraqitur një aktvendim të Gjykatës Themelore, të nxjerrë në procedurë jokontestimore, me të cilën vërtetohet se ka ekzistuar një person me emrin [Rr. M.] (vëlla i parashtruesit), i cili ka qenë me aftësi të kufizuara dhe se i njëjti ka vdekur pa lënë trashëgimtar në vitin 1971 dhe se parashtruesi e ka trashëguar parcelën në fjalë prej tij”. Ai gjithashtu pretendon se çështja e figurës së veprës penale po ashtu nuk është arsyetuar nga gjykatat e rregullta.*

52. Përkitazi me këtë, Gjykata fillimisht thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore, si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta hyjnë në fushën e ligjshmërisë dhe, si të tilla, parimisht, nuk janë çështje të Gjykatës Kushtetuese (shih, rastet e Gjykatës nr. [KI06/17](#), me parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; [KI75/17](#), me parashtrues X, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 55; [KI103/24](#) me parashtrues *Sylejman Zeneli*, Aktgjykim i 11 shtatorit 2024, paragrafi 45).
53. Megjithatë, Gjykata mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime mund të kenë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih rastin e Gjykatës [KI75/17](#), parashtrues X, Aktgjykim i 30 janarit 2018, paragrafi 59; [KI89/22](#), parashtrues *Xhelal Plakolli*, cituar më lart, paragrafi 44; dhe [KO103/24](#), parashtrues *Sylejman Zeneli*, cituar më lart, paragrafi 47).
54. Sa i përket të drejtës për vendim të arsyetuar, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të cilën e ka përvetësuar edhe Gjykata, rezulton, ndër të tjera, se (i) garancitë e mishëruara në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenin 31 të Kushtetutës, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre; (ii) vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë; (iii) gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, duhet të japin arsye dhe arsyeime të tilla të cilat do t'ua mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës; (iv) paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së dhe neni 31 i Kushtetutës i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument; dhe se (v) nga natyra e vendimit që merr, varet nëse gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysht, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtrësive që një palë mund t'i paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjykimeve (për një elaburim më të detajuar përkitazi me parimet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar shih, rastet e GJEDNJ-së, *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003, paragrafi 34; *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, Aktgjykim i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30; *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 26; *Perez kundër Francës*, nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81; *Ruiz Toria kundër Spanjës*, nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; si dhe rastet e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2022, paragrafët 113-124; dhe [KI164/23](#), [KI173/23](#), [KI174/23](#), [KI175/23](#), [KI176/23](#) dhe

KI201/23, parashtrues Murat Sylja, Gentian Sylja, Shqipe Kelmendi, Rinor Sogojeva, Asdren Mustafaj, dhe Besnik Elshani, cituar më lart, paragrafët 148- 150).

55. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata rikujton arsyetimin e Aktgjykimit [P. nr. 274/2015] të 21 shtatorit 2022, të Gjykatës Themelore, e cila e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale “Legalizim i përmbajtjes së rreme”. Në këtë kontekst, Gjykata specifikisht sjellë në vëmendje arsyetimin e Gjykatës Themelore përkitazi me përmbushjen e elementeve të figurës së veprës penale të lartcekur, me ç’ rast e njëjta kishte arsyetuar se “I pandehuri e ka vënë në lajthim këtë Gjykatën, duke e prezantuar dokumentin e rrejshëm se ka ekzistuar një person me emrin [Rr. M.] (vëlla i të pandehurit), për arsye për me marrë pronën ngastrën kadastrale nr. 893/1, në sipërfaqe prej 0.47,00ha, edhe pse kjo pronë ka qenë e familjes rome [S. M.], e kur dihet se i pandehuri ka bërë propozim për vërtetimin e vdekshmërisë së [Rr. M.] (vëllait të tij), të cilin Gjykata e ka vërtetuar me aktvendimin Nd. Nr. 29/2001, dt. 09.04.2001, e Gjykatës nuk i ka prezantuar ndonjë dëshmi para vitit 1999”.
56. Tutje, Gjykata vë në pah edhe arsyetimin e Gjykatës së Apelit përkitazi me figurën e veprës penale, me të cilin aktgjykim edhe e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ndër të tjera, duke e ricilësuar veprën penale:

*“[...] është vërtetuar jashtë çdo dyshimi prezantimi i fakteve të rrejshme nga i akuzuari [parashtruesi i kërkesës] gjykatës përkatëse me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të cekur më lart, dhe nëse është kështu, edhe aktgjykimi i vitit 2002 është administruar si provë me rastin e vendosjes në vitin 2014, pra përdorimi i këtij vendimi gjyqësor duke e ditur se është i mbështetur në fakte të rreme, nënkupton se i akuzuari ka qenë i njohur me këtë rrethanë, kjo e cila vërtetohet edhe nga seanca e shqyrtimit kryesor, kur përfaqësuesi i autorizuar i të akuzuarit thirret në aktgjykimin e vitit 2002, dhe kjo është rrethanë vendimtare që e inkriminon të akuzuarin, duke e përdorur aktgjykimin e vitit 2002, me rastin e vendosjes në çështjen meritorë në vitin 2014.*

*[...] kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me përdorim të dokumentit – aktgjykimit për të cilin si rezultat i provave joreale, me rastin e vendosjes me aktgjykimin e vitit 2002, andaj veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale nga i akuzuari është pikërisht përdorimi i këtij vendimi si provë dhe vlerësimi i kësaj prove me rastin vendosjes me datën 03.06.2014, ku siç është konstatuar në procesverbalin e shqyrtimit kryesor, ndër të tjera, përfaqësuesi i autorizuarit atëherë i të paditurit tani të akuzuarit, është thirrur në aktgjykimin C.nr.85/2001, dhe nuk është relevante dorëzimi fizik i këtij aktgjykimi, përderisa, tani i akuzuari ka qenë i njohur në përmbajtjen e këtij aktgjykimi dhe jo vetëm këtë, por, objekt vlerësimi ka qenë edhe aktvendimi për trashëgimi, të dyja këto aktvendime me përmbajtje të rreme [...]”. Gjykata vëren se arsyetimin e Gjykatës së Apelit e kishte vërtetuar edhe Gjykata Supreme.*

57. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe përmbajtjes së nenit 403 të KPRK-së, ku përcaktohet vepra penale “Legalizimi i përmbajtjes së rreme”, si në vijim:

*“1. Kushdo që vë në lajthim organin kompetent që në një dokument publik, regjistër apo libër të vërtetojë një çështje të pavërtetë, të paraparë për të shërbyer si provë në një çështje ligjore, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.*

*2. Kushdo që përdorë dokumentin, regjistrin apo librin e tillë edhe pse e di se është i rremë, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni”.*

58. Gjykata vëren se, në thelb, gjykatat e rregullta, më specifikisht Gjykata e Apelit, e kualifikoi Aktgjykimin [C. nr. 85/2001] e 19 prillit 2002, të Gjykatës Themelore (i referuar në aktgjykimin e saj si “aktgjykimi i vitit 2002”), si “dokument publik” dhe pas administrimit të provave relevante, përfshirë deklaratat e dëshmitarëve, që e vërtetojnë gjendjen faktike, erdhi në përfundim se i njëjti ka përmbajtje të rreme. Ajo në këtë drejtim, konstatoi se përdorimi i këtij dokumenti publik nga ana e parashtruesit të kërkesës, respektivisht të pandehurit në procedurë penale, duke qenë në dijeni se i njëjti ka përmbajtje të rreme, plotëson kushtet ligjore për kryerjen e veprës penale nga paragrafi 2 i nenit 403 të KPRK-së.
59. Prandaj, bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta i kanë dhënë përgjigje parashtruesit të kërkesës për pretendimet e tij për përmbushjen e elementeve të veprës penale “Legalizim i përmbajtjes së rreme”, duke elaboruar të drejtën materiale dhe procedurale të aplikueshme në rastin konkret.
60. Për më tepër, nga arsyetimi i konkluzioneve të gjykatave të rregullta, vërehet qartë se në dritën e rrethanave të rastit konkret, nuk kemi të bëjmë as me “aplikim të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar” dhe as me “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” nga ana e gjykatave të rregullta, përshirë Gjykatën Supreme.
61. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për interpretim qartazi arbitrar të ligjit dhe vendim të paarsyetur në kuadër të shkëljes së të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm sa i përket figurës së veprës penale “Legalizim i përmbajtjes së rreme”, janë pretendime që bien në kategorinë e “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
62. Përkitazi me pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thekson gjithashtu se pretendimet kryesore ankimore të tij kanë mbetur të paadresuara nga të gjitha shkallët gjyqësore, siç janë: (i) shkëljen e paragrafit 3 të nenit 311 (Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues gjatë shtyrjes) të KPP-së, respektivisht, që shtyrja e shqyrtimit ka zgjatur më shumë se 3 (tre) muaj dhe se është dashur që shqyrtimi të mbahet para një trupi tjetër gjykues dhe të shqyrtohen të gjitha provat; (ii) në lidhje me shqiptimin e dënimit; si dhe që (iii) disa pretendime dhe argumente të tjera janë trajtuar në mënyrë sipërfaqësore me argumente të përgjithshme, sipërfaqësore dhe gjuhë “shabllonike”.
63. Përkitazi me adresimin e pretendimit të parashtruesit që e kishte ngritur në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në lidhje me shkëljen e paragrafit 3 të nenit 311 të ish KPP-së, respektivisht, që shtyrja e shqyrtimit ka zgjatur më shumë se 3 (tre) muaj dhe se është dashur që shqyrtimi të mbahet para një trupi tjetër gjykues dhe të shqyrtohen të gjitha provat, Gjykata i referohet kësaj dispozite ligjore e cila përcakton, ndër të tjera, se: “[...] 3. Kur shtyrja ka zgjatur më shumë se tre (3) muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të fillojë rishtas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat.[...]”
64. Megjithatë, Gjykata rikujton edhe arsyetimin e Gjykatës Supreme në Aktgjykimin e saj të 25 shtatorit 2023, që thekson se: “Është evidente që sipas dispozitës së nenit 311, par. 3 të KPP-së, kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor fillon rishtas. Por në rastin konkret në këtë çështje penale nuk është ndryshuar trupi gjykues sepse çështja është

*shqyrtuar nga gjyqtari i vetëm dhe atë brenda afatit të paraparë ligjor dhe nuk ka pas shtyrje të shqyrtimit ashtu siç pa të drejtë pretendohet në kërkesën e të dënuarit”.*

65. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se dispozitat e nenit 311 (Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues gjatë shtyrjes) të KPP-së janë të aplikueshme në rastet kur çështja shqyrtohet nga trupi gjykues dhe jo nga gjyqtari i vetëm, siç është rasti konkret dhe se, siç rezulton nga arsyetimi i Gjykatës Supreme gjykimi është kryer brenda afatit të paraparë ligjor.
66. Gjykata gjithashtu vëren se në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruesit për shqiptimin e dënimit, Gjykata e Apelit kishte zbutur dënimin e tij duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese në rastin konkret, dhe shndërruar dënimin e tij kryesor me burgim prej 9 (nëntë) muajve, në dënim me kusht, respektivisht, vendosi që të mos e ekzekutojë dënimin me burgim, nëse në periudhën prej 2 (dy) viteve, parashtruesi nuk kryen vepër tjetër penale.
67. Tutje, lidhur me pretendimet e parashtruesit se disa nga pretendimet ankimore të tij, janë trajtuar në mënyrë sipërfaqësore, dhe me argumente të përgjithshme, sipërfaqësore dhe gjuhë “shabllonike” nga ana e Gjykatës Supreme, Gjykata po ashtu vë në pah pjesë nga arsyetimi i kësaj gjykate, e cila duke iu përgjigjur pretendimeve ankimore të parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, theksoi se: *“Po ashtu, deklarata e të dënuarit [parashtruesit të kërkesës], përveç që është në kundërshtim me vet veten edhe me të gjitha provat e tjera që gjenden në shkresat e lëndës, duke filluar nga përshtkrimi i rrethanave lidhur me bartjen e kësaj prone nga prindërit e të dënuarit tek personi me emrin [Rr.M], duke u përpjekur me arsyetuar se i njëjti ka qenë i sëmurë, i palëvizshëm se ka vdekur diku në moshën 36-37 vjet, është varrosur veçmas, se i ati i tyre ka pasur shumë paluajtshmëri, se për varrimin e tij nuk ka marrë pjesë askush nga të afërmit këto që nuk qëndrojnë. Rrethana që janë edhe në kundërshtim edhe me provat tjera materiale të konstatuara nga ana organeve administrative dhe gjyqësore në Malishevë, i cili person asnjëherë më parë nuk ka qenë i regjistruar as në librin amë të të lindurve dhe as në atë të të vdekurve, rrjedhimisht as si bartës i ndonjë të drejte pronësore siç është konstatuar në regjistrin kadastral në 1945, ishte bartur në emër të [Rr.H.M.], e duke pasur për bazë faktin e lindjes së këtij personi [Rr], në asnjë mënyrë nuk është vërtetuar se kjo pronë ka qenë në emër të vëllait të të dënuarit”.*  
[...]

*[...] gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit pas vlerësimit të provave gjeti se fajësia e të dënuarit u vërtetua me deklaratat si në vijim: e dëshmitarit [H.M], i cili në deklarin e tij ka theksuar se e njeh familjen e [H.M], ku me këtë familje ka qenë në fqinjësi dem baba dem, se i njeh të gjithë meshkujt e kësaj familje dhe se nuk është në dijeni se kjo familje ka pasur ndonjë mashkull me emrin Rrustem. Dëshmitari [I.M.], ku në shqyrtimin gjyqësor ndër të tjera ka deklaruar se është i moshës 65 vjeçare, se prona i takon [Rr.H.M], i komunitetit rom ngase në atë pjesë të qytetit kanë jetuar pjesëtar të atij komuniteti, dhe nuk ka dijeni se i dënuari [parashtruesi i kërkesës] dhe familja e tij ka pasur vëlla me emrin [Rr]. Po ashtu edhe dëshmitari [B.H], në shqyrtim gjyqësor ku ndër të tjera ka deklaruar se deklaratat e dhëna në polici dhe prokurori, ndër pyetjet që i janë bërë i kujtohet se është pyetur edhe për emrat e vëllezërve të [parashtruesit të kërkesës], ka deklaruar se i njeh të gjithë por me emër [Rr] kurrë nuk ka dëgjuar se familja e tyre kanë pasur”.*

68. Gjykata vëren se në thelb se gjykatat e rregullta parashtruesin e kërkesës e kishin shpallur fajtor për veprën penale “Legalizim i përmbajtjes së rreme”, duke u bazuar në deklaratat e dëshmitarëve relevant dhe dokumentacionit përkatës, me të cilat u vërtetua një gjendje e re faktike. Përkitazi me pretendimet të lartcekura të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se të njëjtat ishin trajtuar në mënyrë të mjaftueshme dhe në mënyrë specifike nga gjykatat e

rregullta, ndër të tjera, duke shpjeguar raportin midis fakteve të paraqitura dhe zbatimit të bazës ligjore në të cilin ajo është thirrur, gjegjësisht në çfarë mënyre ato vijnë në korrelacion me njëra-tjetrën.

69. Në dritën e asaj çka u tha më lart, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta i kanë dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore të parashtruesit të kërkesës, duke u bazuar në të gjitha argumentet e tyre të reflektuara më lart. Rrjedhimisht, pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese në “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” ashtu siç përcaktohet me paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

## II. Përkitazi me pretendimin për mospranimin e provave

70. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu në plotësimin e kërkesës së tij më 9 janar 2024, pretendon se i është shkelur edhe e drejta në mbrojtje të barabartë dhe gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak se: (i) i janë hequr dokumente nga dosja penale, respektivisht dokumenti me emërtimin “*Abucni registar*” apo ekstrakt nga regjistri i të drejtave pronësore në patundshmëri dhe se kur parashtruesi në procedurë penale kishte kërkuar që ky dokument të administrohej si provë, Gjykata Themelore në seancë gjyqësore e kishte refuzuar administrimin e saj me arsyetimin se është provë e natyrës civile dhe jo penale; (ii) sipas tij, aktgjykimi fajësues i tij mbështetej në prezumimin se ngastra lëndore ishte në pronësi të një familjeje rome pa u bazuar në prova por vetëm në deklarinimin e palës së dëmtuar; si dhe (iii) ishte targetuar si fajtor i vetëm, edhe pse në këtë çështje mund të ishin akuzuar edhe familjarët e tij.
71. Gjykata rikujton se më 24 shtator 2024, i kërkoi parashtruesit të kërkesës që t’ia dorëzojë kopjen e të gjitha ankesave dhe kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë. Mirëpo, në lidhje me këtë kërkesë të saj, Gjykata nuk ka pranuar përgjigje nga parashtruesi i kërkesës. Pavarësisht kësaj, Gjykata vëren që nga shkresat e lëndës, respektivisht, vendimet gjyqësore respektive të gjykatave të rregullta dhe dy kopjeve të kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë, nuk rezulton që parashtruesi i kërkesës pretendimin për mospranimin e provave nga gjykatat e rregullta, në mënyrë specifike ta ketë ngritur para gjykatave të rregullta, gjegjësisht, para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme. Po ashtu, Gjykata konsideron se është obligim i parashtruesit që të dëshmojë se e ka shterur këtë pretendim para gjykatave të rregullta, të cilin obligim nuk e ka përmbushur para Gjykatës Kushtetuese.
72. Në një kontekst të tillë, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJENDJ-së, sa i përket kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin substancial dhe rikujton se në rrethana të tilla, pretendimet e tilla nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata për mungesë të shterimit të mjeteve juridike në kuptim substancial. Bazuar në po të njëjtën praktikë gjyqësore, Gjykata kishte refuzuar shqyrtimin e pretendimeve përkatëse sepse të njëjtat nuk ishin ngritur asnjëherë para gjykatave të rregullta, ndër të tjera, edhe në rastet e Gjykatës, [KI119/17](#), parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2009, paragrafi 71, [KI154/17 dhe KI05/18](#), parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, paragrafi 92, [KI155/18](#), parashtrues *Benson Buza*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shtatorit 2019, paragrafi 50, [KI163/18](#), parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020, paragrafi 59 dhe [KI40/20](#), parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafi 66.



73. Gjykata rithekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “*substancë*” para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dy kuptimet. (Shih, po ashtu, rastet e Gjykatës, [KI71/18](#), parashtrues, *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafin 73; rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 94; dhe rastin KI163/18, cituar më lart, paragrafi 61; KI40/20, cituar më lart, paragrafi 67).
74. Një qëndrim i tillë është në përputhshmëri të plotë me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën, për aq sa ekziston një mjet juridik që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë, të paktën në substancë, argumentin për shkelje të një të drejte, atëherë ai mjet juridik duhet të shfrytëzohet. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, pranë gjykatave të rregullta kur ka mundur të ngrihet gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi të cilën rregulli për shterimin e mjeteve juridike synon ta ofrojë (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, [Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 2478/15 dhe nr.1787/15 Vendim në lidhje me pranueshmërinë i 23 qershorit 2015, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafin 72; rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 93; rastin KI155/18, cituar më lart, paragrafi 49; dhe rastin KI163/18, cituar më lart, paragrafi 60; dhe KI40/20, cituar më lart, paragrafi 67).
75. Marrë parasysh këto parime dhe në rrethana në të cilat, sipas shkresave të lëndës, rezulton se këto pretendime specifike të parashtruesit të kërkesës janë ngritur për herë të parë para Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhënë mundësinë Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, që të adresojnë këto pretendime dhe me atë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngre drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, [KI118/15](#), parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-39; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafi 74; rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 95; dhe rastin KI163/18, cituar më lart, paragrafi 62).
76. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se pretendimi përkitazi me përjashtimin e gjyqtarit duhet të refuzohet si i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

### III. Përkitazi me pretendimet për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës

77. Në fund, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimeve të trajtuara më lart, pretendon edhe shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës. Megjithatë, në këtë kontekst i njëjti vetëm përmend këtë nen, por nuk elaboron dhe shtjellon mjaftueshëm si dhe pse ka ardhur deri te shkelja e këtij neni nga ana e gjykatave të rregullta. Siç është shprehur edhe në rastet e tjera, Gjykata përsërit qëndrimin e saj se vetëm përmendja dhe

citimi i neneve të Kushtetutës apo instrumenteve të tjera ndërkombëtare, nuk mjafton për të ngritur pretendime për shkelje të të drejtave kushtetuese. Kur pretendon për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, parashtruesi duhet të paraqesë dëshmi dhe argumente bindëse, për të dëshmuar shkeljet e supozuara (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues, *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; [KI166/20](#) parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 52; [KIO4/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39, dhe [KI64/22](#), parashtrues *Vatani Shpk*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 shtatorit 2022, paragrafi 77).

78. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, duhen deklaruar qartazi të pabazuara në kategorinë e pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit, si dhe pikën (d) të paragrafit (1) dhe paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit, dhe me pikat (b) dhe (d) të paragrafit (1) dhe paragrafit (2) të rregullit 34, si dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 48 të Rregullores së punës, më 26 nëntor 2024, njëzëri:

### VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Jeton Bytyqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani